Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-10/26
24.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-10/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 2, pika d, dhe nenit 14, të Ligjit Nr. 03/L–040, Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/15, qershor 2008), nenit 17, të Ligjit Nr. 06/L–092, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 10/03, prill 2019); nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës; nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 15, të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 24.09.2026, në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0055100-9/26 dt. 24.09.2026 Për miratim paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik/juridik (parcela Nr. 01870-5), sjell këtë:

VENDIM
Për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës sipas Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0055100-10/26 dt. 24.09.2026

1. Me këtë vendim FORMOHET Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për Parcelën Kadastrale P-71208072-01870-5, sipas Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0055100-10/26 dt. 24.09.2026, në përbërje:
   1.1 Egzon Mehmeti - nga Kuvendi i Komunës
   1.2 Oltion Ahmeti - nga Kuvendi i Komunës
   1.3 Albina Kastrati Rama - nga ekzekutivi i Komunës
   1.4 Fitore Mehmeti Behrami - nga ekzekutivi i Komunës
   1.5 Edin Lahu - anëtar nga sektori jo qeveritar.
2. Komisioni vlerësues është përgjegjës për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës konform nenit 19 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës
3. Komisioni vlerësues bazë për punën e tij e ka Ligjin Nr. 06/L–092, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi nga fusha përkatëse.
4. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues sipas kërkesës së tij.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komisioni i emëruar me këtë vendim.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:
1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje:
1 x 1 Kryetarit të Komunës
1 x 1 Anëtarët e Komisionit